



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

(i përmbledhur)¹

Tiranë, më 29.12.2020, ora 14.00

Drejton mbledhjen -
Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

Paraqitja e Raportit Vjetor për Veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|--------------|
| 1. Vitore Tusha | (zv/kryetar) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Saida Dollani | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. Avokati i Popullit, përfaqësuar me autorizim nga **Enio Haxhimihali**.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi me autorizim i Presidentit të Republikës.
2. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

HAPET MBLEDHJA

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës.

Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Bën me dije se mungon anëtari Ludovik Dodaj, për arsye shëndetësore.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Propozon që të përfshihet në rendin e ditës edhe miratimi i procesverbalit të përmbledhur të datës 23.12.2020, i cili u është shpërndarë të gjithëve dhe në të janë reflektuar edhe komentet dhe sugjerimet e paraqitura.

Fton anëtarët të miratojnë rendin e ditës.

Anëtarët miratojnë rendin e ditës.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë koment përfaqësuesi i Avokatit të Popullit.

Enio Haxhimihali shprehet se duke qene së janë dhe dy mbledhje të tjera dhe Këshillit i mbaron mandati sot, nuk e di si do të procedojë me miratimin e dy procesverbaleve të tjera, të mbledhjeve të djeshme.

Vitore Tusha sqaron se Këshilli po ecën me ato që janë arritur të transkriptohen dhe nëse koha do e mundësojë do të mbyllen të gjitha në varësi të kohës, burimeve njerëzore dhe volumit të punës. Sqaron se sekretaria sapo e vuri në dijeni që është transkriptuar edhe procesverbali i datës 22 dhjetor dhe të gjithë do kenë kohën e duhur që ta shohin që para se të mbyllet kjo mbledhje të miratohet edhe ky procesverbal, pasi të jenë njohur më të dhe të jenë të qartë në lidhje me përmbajtjen edhe mënyrën e përmbledhjes së tij.

Kërkon nga sekretari që t`u shpërndahet të gjithëve nga një kopje e këtij procesverbali.

Propozon që të përfshihet në rendin e ditës edhe miratimi i procesverbalit të datës 22 dhe fton anëtarët të votojnë.

Anëtarët miratojnë propozimin që të përfshihet në rendin e ditës edhe miratimi i procesverbalit të datës 22.12.2020.

Vitore Tusha vijon me rendin e ditës, që është miratimi i procesverbalit të përmbledhur të datës 23.12.2020.

Anëtarët miratojnë procesverbalin e përmbledhur të datës 23.12.2020.

Vitore Tusha vijon me rendin e ditës, që është miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është një organ që në përputhje me Kushtetutën ushtron veprimtarinë e tij brenda një viti. Ai konstituohet në Janar të çdo viti dhe mbaron veprimtarinë në 31 Dhjetor të po atij viti. Shprehet se Këshilli gjatë vitit 2020 ka zhvilluar një veprimtari shumë voluminoze, një veprimtari procedurale që ka filluar nga data 15 Janar 2020 dhe beson se përfundon me mbledhjen e sotme. Sqaron se në raportin vjetor që u është vënë në dispozicion të gjithëve janë pasqyruar të gjitha veprimet procedurale që ky Këshill ka zhvilluar, duke nisur që nga konstituimi i organit, përbërjen e tij, përfundimin e mandateve të disa anëtarëve, si dhe me periodicitetin apo mënyrën e thirrjeve, si dhe zhvillimit të procedurave për vakancat përkatëse. Në raport kanë gjetur vend edhe problematikat me të cilat ky Këshill është hasur gjatë vitit dhe që janë trajtuar prej tij. Po ashtu, është përfshirë veprimtaria rregullatore dhe normative për vitin 2020 dhe e gjithë procedura që është zhvilluar për përshtatjen dhe ndryshimet e akteve nënligjore, si fillim mbi sugjerimin e anëtarit zëvendësues znj. Xhaferllari dhe më pas, bazuar në rekomandimet e Komisionit të Venecias, arsye për të cilën u ngrit një grup pune i përbërë nga znj. Dollani dhe znj. Xhaferllari. Në raport në mënyrë të detajuar është pasqyruar procedura e ndjekur për vakancën e shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe për dy vakancat e shpallura nga Presidenti i Republikës, në përfundim të të cilave kanë filluar detyrën tre anëtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe tashmë kemi një Gjykatë Kushtetuese funksionale me përbërje prej shtatë anëtarësh.

Në Raport është evidentuar edhe situata në lidhje me vakancat që kanë si organ emërtese Gjykatën e Lartë dhe procedurat që janë zhvilluar deri më tani dhe që kërkojnë në të ardhmen bashkëveprim mes KLGJ-në, KED-në dhe Gjykatës së Lartë.

Në Raport janë pasqyruar edhe të dhënat që lidhen me numrin e mbledhjeve që janë zhvilluar, numri i vendimeve që janë marrë, numri i urdhrave të miratuara, si dhe të shkresave të dala dhe të hyra në Këshill. Është evidentuar në detaje e gjithë veprimtaria që është kryer.

Në Raport janë parashtruar edhe dy problematika të konstatuara ky Këshill. Njëra lidhet me procedurën e shortit pasi Gjykata e Lartë duhet të marrë masa sepse ligji kërkon që shorti të zhvillohet në mënyrë elektronike por janë bërë tashmë 2 vite që, edhe pse është ngritur si problem referuar edhe kërkesës ligjore, Këshilli ka proceduar me shortin manual. Tjetra lidhet me çështjen e stafit mbështetës administrativ, që duhet të jetë më i shumtë në numër.

Pyet anëtarët nëse kanë ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim që të bëhet pjesë e këtij raporti në mënyrë që të jetë sa më i plotë dhe të pasqyrojë sa më mirë veprimtarinë e kryer dhe ato rekomandime apo konkluzione që janë arritur.

Fajtona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se nuk ka pyetje apo sugjerime por shpreh vlerësimin për punën e bërë në përgatitjen e raportit, i cili është një raport voluminoz që do shumë punë dhe impenjim pasi gjithë veprimtaria ka qenë shumë e ngarkuar këtë vit dhe ka pasur shpallje dhe rishpallje vakancash. Personalisht nuk gjen ndonjë të metë ose nevojë për ndonjë plotësim.

Vitore Tusha pyet nëse Avokati i Popullit ka diçka për të thënë.

Enio Haxhimihali shprehet se vlerësojnë punën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020 sepse tashmë Gjykata Kushtetuese është funksionale pas shumë vitesh. Që nga miratimi i paketës së ligjeve të reformës në Drejtësi i ra barra historike pikërisht KED të 2020 që ta përmbushte këtë mision. Për sa i përket detajeve teknike si procedura, ndonjë rregullore që nuk u miratua apo gjëra të tjera, nuk është vendosur ende në se institucioni i Avokatit të Popullit ashtu si vitin e kaluar (pra vitin 2019), do të hartojë një raport të veçantë për gjetjet e këtij organi, pra për punën e KED-së 2020, apo gjetjet tona do të përfshihen në raportin vjetor që do të paraqitet Kuvendit. Përgëzon Këshillin për punën e madhe që bëri gjatë këtij viti dhe që arriti të bënte funksionale Gjykatën Kushtetuese.

Vitore Tusha i jep fjalën përfaqësueses së Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

Mimoza Arbi shprehet se në lidhje me raportin ai përfshin të gjithë veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi gjatë vitit 2020 dhe është përshkruar në mënyrë të përmbledhur gjithë veprimtaria, aktet, vendimmarrjet, për tre vakancat që ka shqyrtuar KED-ja gjatë vitit 2020. Për raportin nuk ka ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim. Ky është një raport përmbledhës dhe nëse do të shihet puna voluminoze e vendimmarrjes që ka marrë KED-ja gjatë vitit 2020 ajo është shumë herë më e madhe sesa përmbajtja e këtij raporti. Natyrisht, raporti ka përmbledhur pikërisht këtë veprimtari. Si përfaqësuesja e Kryetarit të Kuvendit në mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi përgëzon punën që ka bërë Këshilli, natyrisht duke ditur edhe situatat sesi i ka kryer, në kushtet e një pandemie e cila pengoi punën e një veprimtarie normale të shumë institucioneve. Edhe në këto kushte KED-ja ka zhvilluar rregullisht veprimtarinë për të përmbushur misionin apo detyrimin kushtetues dhe ligjor që ka për plotësimin e vendeve vakant në Gjykatën Kushtetuese dhe nga KED-ja 2020 u bë e mundur dhe u arrit vënia në funksionim e kësaj Gjykate, e cila ishte një kërkesë imediate e faktorit brenda vendit por edhe e faktorit ndërkombëtar. Ishte një kërkesë imediate e jona për konsolidimin e shtetit ligjor. Përgëzon punën e palodhur që ka pasur dhe ka zhvilluar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2020.

Vitore Tusha i jep fjalën përfaqësuesit të Presidentit të Republikës.

Bledar Dervishaj shprehet se e ka studiuar raportin dhe në tërësi ai përmban të gjitha veprimet procedurale të Këshillit edhe ato problematika që ka konstatuar ky Këshill gjatë këtij viti kalendarik. Përgëzon punën dhe veprimtarinë e Këshillit, në 6 mujorin e dytë, i cili ka qenë shumë efektiv sa i takon vlerësimin, verifikimin të kandidatave për të 3 vakancat që ky Këshill kishte në proces apo trashëgoi nga Këshilli i vitit 2019. Një vlerësim paraprak të problematikave që është ndeshur Këshilli ai e ka trajtuar gjatë 2 mbledhjeve, data 16 Shtator dhe data 5 Tetor, ku ka miratuar edhe një deklaratë mbi veprimtarinë e deriatëhershme. Në këto mbledhje u kërkuar që materiali të ishte më ezaures për problematikën, çka në përgjithësi e gjen të parashikuar në këtë

raport. Megjithatë, sugjeron që në faqen 14, 18 dhe 22 aty ku mbyllet veprimtaria e Këshillit për secilën vakancë, të shtohet informacioni se tashmë Këshilli është njoftuar nga organi i emërtesës, si nga Kuvendi dhe nga Presidenti në lidhje emërimin e gjyqtarëve, kryerjen e betimit dhe fillimin e ushtrimit të detyrës, për të cilat Këshilli ka marrë dijeni. Ndoshta në faqen 6 ka një sugjerim, pas situatës ligjore lidhur me mandatin e Gjykatës së Lartë, të shtohet edhe moszhvillimi i mbledhjeve apo mosthirrja e mbledhjeve për një periudhë deri në 23 qershor, çka mendon se duhet të pasqyrohet, por gjithësesi kjo lihet në vlerësim të Këshillit. Po ashtu, në faqen 23, ku flitet për veprimtarinë e 2019 në lidhje me vakancat e Gjykatës së Lartë, procedura e thirrjes dhe ecuria mund të japë një tablo se ku ngelet çështja për zgjidhje dhe për emërim. Në pjesën tjetër nuk ka ndonjë sugjerim apo vërejtje mbi raportin e Këshillit.

Në emër të Presidentit shpreh veçanërisht për Këshillin vlerësimin për eficensën e treguar në këto 3 muajt e fundit, ku i është dashur të përballet me një volum të madh pune administrative, vlerësim të shkresave të institucioneve por edhe të proceseve gjyqësore. Tashmë të dy organet e emërtesës, Presidenti dhe Kuvendi, e kanë mbyllur emërimin e kuotave të tyre në Gjykatën Kushtetuese dhe ngelet prioritet veprimtaria e KLGJ-së për plotësimin e Gjykatës së Lartë dhe shpallja e aplikimeve për vakancat, prej Gjykatës së Lartë dhe emërimit prej tyre të 3 anëtarëve të tjerë të Gjykatës Kushtetuese, për ta bërë atë plotësisht funksionale dhe të qëndrueshme në vendimmarrje.

Vitore Tusha fton anëtarët që të shprehen në lidhje me këto propozime.

Anëtarët shprehen dhe miratojnë që të përfshihen në raport edhe të dhënat e fundit që lidhen me emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj sipas vakancave, dekretimin dhe bërjen e betimit prej tyre.

Vitore Tusha fton anëtarët që të miratojnë raportin.

Anëtarët miratojnë Raportin Vjetor për Veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2020.

Vitore Tusha propozon një pushim të shkurtër në mënyrë që gjithësecili të ketë kohën e mjaftueshme për t'u njohur me përmbajtjen e procesverbalit të datës 22 dhjetor para miratimit të tij.

Ndërpritet mbledhja.

Rifillon mbledhja.

Vitore Tusha vijon mbledhjen me miratimin e procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes së KED-së të datës 22.12.2020. Sqaron se pasi janë të njohur të gjithë me procesverbalin janë pasqyruar në të edhe sugjerimet.

Fton anëtarët të miratojnë procesverbalin.

Anëtarët miratojnë procesverbalin e përmbledhur të mbledhjes së KED-së të datës 22.12.2020.

Vitore Tusha pyet nëse Avokati i Popullit ose të ftuarit kanë diçka për të shtuar.

Enio Haxhimihali dhe **Bledar Dervishaj** shprehen se nuk kanë gjë për të shtuar.

Vitore Tusha falënderon të gjithë anëtarët për bashkëpunimin shumë të mirë, ku të gjithë kanë qenë të papërtuar dhe kanë punuar me shumë intensitet dhe me volum, duke pasur në konsiderate dhe volumin shumë të madh që ka pasur secili prej anëtarëve në detyrën e tij funksionale. Vlerëson se Këshilli e përmbushi misionin e tij me sukses.

Falënderon Avokatin e Popullit që i ka mbikëqyrur dhe monitoruar të gjitha procedurat e zhvilluara veçanërisht pas zgjerimit të kompetencës në korrik 2020, i cili ka qenë i pranishëm dhe ka monitoruar në çdo moment, në çdo vendimmarrje në çdo dokument që është administruar. Po ashtu, falënderon përfaqësuesin e Presidentit të Republikës dhe përfaqësuesen e Kryetarit të

Kuvendit, të cilët kanë qenë të pranishëm në të gjitha mbledhjet që Këshilli ka zhvilluar në mënyrë të pandërprerë dhe e kanë mbështetur punën e këtij Këshilli. Shprehet se pa një bashkëpunim institucional nuk do të ishte e mundur që ta realizoheshin dhe të arriheshin këto rezultate të mirëpritura.

Duke falënderuar personalisht të gjithë dhe duke uruar “Gëzuar Vitin e Ri, shëndet në familje dhe gjithë të mirat”, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbyllet mbledhja në orën 15.21

Tiranë, më datë 29.12.2020

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA